**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MARIANA DAKA**
**ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE**
**TEL: 0692058147**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 1491** **Nr. koleksioni: 682**

**Tirane më 23/09/2020**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2020053860059235049

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë

A2020053860059235049

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**
***(TË SHOQËRISË "IBERIC DRESS STYLE" SH.P.K)***

Sot, më datë 23 Shtator 2020, para meje Notere MARIANA DAKA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqit personalisht:

**Z. Artan Sevrani,** atësia Fetah, i datëlindjes 17.07.1966, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 032208406 dhe me numër personal G60717085S, autoritet lëshues MB.;
në cilësinë e ***Ortakut***, në masën 25%, të Shoqërisë **"Iberic Dress Style" Shpk**, person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 12.01.2017, pranë QKB, me seli në adresën: Nj.Bashkiake nr.2, Bulv."Bajram Curri", Godina ETC, Pasuria me numër 2/276-N25, vol.39, faqe 51, Z.K.8160, Tiranë, me Numër Identifikimi NIPT L71312016G, i quajtur më poshtë si "***Shitësi***".

**"MC INVESTMENT GROUP" SH.P.K.**person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 09.07.2014, pranë QKB, me NIPT L41909013F, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", pallati 8, Hyrja 1, Tiranë përfaqësuar nga **Z.Eduard HYSENI**, i biri i Abdulla-it dhe i Qerime-s, I datëlindjes 05.07.1966, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga "Aleksander Moisiu", madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje noteres me Letërnjoftimit me numer 032940972 dhe me numër personal G60705042K; të quajtur më poshtë si ***"Blerësi"*** dhe

**Shoqëria "Albeton 5" Shpk**, e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar sipas Vendimit Nr. 6754 datë 15.09.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT J61817008G, me seli në adresën: Rruga "Perlat Rexhepi", Godina 2-13 kate, Kati 2, Tiranë, përfaqësuar nga **Z.Adrian Dulaku**, sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të saj (bashkëlidhur si Aneksi 1); të quajtur më poshtë si ***"Blerësi"***.

Të gjithë së bashku të quajtur më poshtë si ***"Palët".***

Pasi verifikova statusin juridik të palëve të sipërpërmendura, bazuar në Nenin 84, 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", unë noterja publike, vërtetoj se palët e sipërpërmendura janë me aftësi juridike për të vepruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të cilët më kërkuan dhe ranë dakort në hartimin e kësaj Kontrate Shitje, bazuar në legjislacionin Shqiptar, sipas termave dhe kushteve të mëposhtme.

## TË DHËNA PARAPRAKE

**1.1.** Z. Artan Sevrani është pronar i 25% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Iberic Dress Style" Shpk, kuota të cilat janë të lira nga çdo pretendim apo barrë në favor të të tretëve.
**1.2.** Shoqëria "Albeton 5" Shpk është pronare e 50% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Iberic Dress Style" Shpk, kuota të cilat janë të lira nga çdo pretendim apo barrë në favor të të tretëve.
**1.3.** MC Investment Group është pronar i 25% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Iberic Dress Style" Shpk, kuota të cilat janë të lira nga çdo pretendim apo barrë në favor të të tretëve.

NENI 1
***Objekti***

a. Objekti i kësaj Kontrate Shitje është kalimi i pronësisë, kundrejt shpërblimit, i 25% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Iberic Dress Style" Shpk, të zotëruara nga ortaku Z.Artan Sevrani, në favor të Blerësve Shoqërisë "Albeton 5" Shpk dhe "MC Investment Group" Shpk.

NENI 2

***Çmimi dhe Pagesa e tij***

Çmimi total për shitblerjen e kuotave të kapitalit, do të jetë në vlerën totale të tij prej **20.000 (Njëzet mijë) Euro, duke u likujduar nga pala blerëse nëpërmjet transfertës bankare në numrin e llogarisë së shitësit, brenda një viti nga data e nënëshkrimit të kësaj kontrate. Çmimi total i shitblerjes do të likujdohet duke u ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet blerësve me nga 10.000 Euro secili. Mandati bankar, në momentin që do të kryhet, do të vërtetojë likujdimin e çmimit të shitjes.**

Me nënshkrimin dhe legalizimin prej Noteres të kësaj Kontrate, Blerësit fitojnë pronësinë e plotë mbi këto kuota dhe kanë të drejtën të depozitojnë këtë Kontratë pranë QKB-së për pasqyrimin e kalimit në pronësi të tyre të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

NENI 3

***Dijeni, përgjegjësi dhe garanci***

Për çfarëdo lloj detyrimi të dalë pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe që i përket Shitësit, tërësisht apo pjesërisht, cilësisë së tij si shtetas apo Ortak i Shoqërisë, apo edhe vetë Shoqërisë, detyrime këto që i përkasin periudhës para nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe që vijnë për shkak ose jo të aktivitetit të Shoqërisë, do t'i takojë vetëm atij dhe nuk mund të kalojë tek Blerësi, së bashku me të drejtat e fituara prej tij nëpërmjet kësaj Kontrate. Çdo detyrim i kërkuar Blerësit nga të tretët apo organet shtetërore, që i referohet periudhës dhe parashikimit të mësipërm lidhur me Shitësin, mund t'i kërkohet drejtpërdrejt këtij të fundit. Në rast se një kërkim i tillë i drejtohet Blerësit, ky i fundit ka të drejtën t'i kundrejtohet menjëherë Shitësit duke kërkuar rivendosjen e të drejtave të cënuara apo vlerave të paguara brenda një afati 5 ditor. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Shitësi, e ngarkon atë me detyrimin e pagesës bashkë me vlerën edhe të një penaliteti në masën 10 % interes mujor.

**NENI 4**

***Taksat dhe Kontributet***

Çdo taksë apo tarifë e cila lidhet me kalimin e pronësisë së kuotave apo gjithçka tjetër që lind si rrjedhojë e përmbushjes së termave të kësaj Kontrate do të kryhet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

**NENI 5**

***Njoftimet***

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e kërkuara apo që mund të lindin nga kjo Kontratë do të kryhen me shkrim dhe do të konsiderohen të marra, nëse dorëzohen personalisht apo me email (me verifikim marrjeje), të dërguara me postë (rekomande) Palëve në adresat e mëposhtme, ose adresa të tjera të përcaktuara me shkrim në vazhdimësi:

a. **SHITËSI:**

**Z. Artan Sevrani**

**Adresa: Rruga "Xhorxh W Bush", Tirane.**

**BLERËSI:**

**Shoqëria "Albeton 5" Shpk**

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi", Godina 2-13 kate, Kati 2, Tiranë
Email: info@edilal.com

**Shoqëria "MC Investment Group" Shpk**
Adresa: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", pallati 8, Hyrja 1, Tiranë

b. Çdo ndryshim në adresat e specifikuara më sipër duhet të njoftohet në kohë dhe me shkrim palës tjetër, duke përdorur të njëjtat metoda siç janë përcaktuar në këtë nen.

NENI 6
***Shpenzimet***

Të gjitha shpenzimet në lidhje me këtë Kontratë, përfshirë kostot e Noterit Publik, do të paguhen nga Palët në mënyrë të barabartë.

NENI 7
***Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve***

a. Kjo Kontratë do të interpretohet sipas Ligjit Shqiptar. Çfarëdo çështje e cila nuk parashikohet nga kjo Kontratë, do të zgjidhet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

b. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve dhe që ka të bëjë me interpretimin, zbatimin, përfundimin e kësaj Kontrate, Palët bien dakort të bëjnë maksimumin e mundshëm për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.

c. Nëse pas përpjekjeve të arsyeshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë miqësore, zgjidhja nuk arrihet për 30 (tridhjetë) ditë nga tentativa e parë për zgjidhje miqësore, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në rrugë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 8
***Konfidencialiteti***

Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të përfshirë në këtë kontratë dhe të mos e kalojnë atë në asnjë formë tek të tretët.

NENI 9
***Anekset e Kontratës***

a. Sikundër është përcaktuar edhe më lart në këtë Kontratë, Palët kanë detajuar në Anekse të posaçme të dhëna të nevojshme dhe të domosdoshme për qartësimin e Kontratës dhe të vetë marrëdhënies ndërmjet Palëve.
b. Në të tilla kushte, këto Anekse do të jenë pjesë përbërëse dhe e pandashme e Kontratës, duke pasur të njëjtën fuqi ligjore për Palët ashtu si edhe vetë kjo Kontratë.

c. Anekset e Kontratës janë:

**Aneksi 1:** Vendimi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk
**Aneksi 2:** Ekstrakt nga QKB i Shoqërisë "Iberic Dress Style" Shpk
**Aneksi 3:** Ekstrakt nga QKB i Shoqërisë "Albeton 5" Shpk

NENI 10

***Të ndryshme***

Kjo kontratë është përgatitur në 5 (pesë) kopje të njëjta në gjuhën Shqipe, nga një kopje prej të cilave i vendoset në dispozicion Shitësit dhe Blerësit, respektivisht, një kopje depozitohet në rregjistrat e QKB-së, një kopje në arkivën e Shoqërisë dhe një kopje mbahet në Zyrën e Noterisë Tiranë.

Kontrata hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të Kontratës nga Palët pjesmarrëse.

Palët në këtë kontratë deklarojnë se janë njohur me përmbajtjen e saj dhe shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë në firmosjen e saj.

**PALËT**

**SHITËSI**
**Z. Artan Sevrani**

**BLERËSI**
**Shoqëria "Albeton 5" Shpk**
**Përfaqësuar nga:**
**Adrian Dulaku**

**Shoqëria "MC Investment Group" Shpk**
**Përfaqësuar nga:**
**Z.Eduard Hyseni**

**NOTERE**
**Mariana Daka**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER MARIANA DAKA**

V2020053860067855923

**DATE 23/09/2020**
**NR.REP 1489**

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 23.09.2020, para meje Notere MARIANA DAKA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**
**Z.Adrian Dulaku,** atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 05 Shkurt 1960, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 035240347 dhe numër personal G00205223S;

**Z. Artan Dulaku,** atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 30 Maj 1965, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Kompleksi i Vilave, Sauk, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 035434059 dhe me numër personal G50530166T

**Z.Genci Dulaku**, atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 19 Dhjetor 1967, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : bulevardi "Bajram Curri", godina ETC, kati i 17, Tiranë, mbajtës i letwrnjoftimit me numër 036045039 dhe me numër personal G71219083M, lëshuar nga MB

**Z.Eduard HYSENI**, i biri i Abdulla-it dhe i Qerime-s, I datëlindjes 05.07.1966, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga "Aleksander Moisiu", madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje noteres me Letërnjoftimit me numer 032940972 dhe me numër personal G60705042K, ne cilesine e perfaqesuesit te shoqerise **"MC INVESTMENT GROUP" SH.P.K.** person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 09.07.2014, pranë QKB, me NIPT L41909013F, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", pallati 8, Hyrja 1, Tiranë dhe

**Z. Artan Sevrani,** atësia Fetah, i datëlindjes 17.07.1966, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 032208406 dhe me numër personal G60717085S, autoritet lëshues MB.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Vendim Asambleje IBERIC DRESS STYLE", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimitnë përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

MARIANA DAKA

# VENDIM
## I ORTAKUT TË VETËM TË
## SHOQËRISË "ALBETON 5" SHPK

Sot, më datë 23 Shtator 2020, në selinë e Shoqërisë "ALBETON 5" Shpk, të ndodhur në adresën: Rr. "Perlat Rexhepi", Godina 2-13 kate, Kati 2, Tiranë, zhvillohet mbledhja e Ortakut të Vetëm të kësaj Shoqërie, konkretisht Shoqëria "Concord Investment" Shpk.

**Shoqëria "Albeton 5" Shpk**, e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar sipas Vendimit Nr. 6754 datë 15.09.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT J61817008G, gjatë veprimtarisë së saj drejtohet nga Administratori Z. Sotiraq Toshi.

Kjo mbledhje e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, e thirrur me kërkesën e Administratorit Sotiraq Toshi, shqyrton këto probleme sipas,

***Rendit të ditës:***

**1.** Miratimin e blerjes së 25% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K të zotëruara nga Z. Artan Sevrani, tek blerësi Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k dhe Shoqëria "MC Investment" Group Shpk. kundrejt vlerës totale prej 20.000 Euro, përkatësisht me nga 10.000 Euro secili.

**2.** Autorizimin e z. Adrian Dulaku, të nënshkruajë aktet përkatëse, si Kontratë Shitje të Kuotave dhe çdo akt tjetër që ka si rend dite:

*a. Kalimin e 25% (njëzet e pesë përqind) të kuotave të kapitalit të zotëruara nga Z.Artan Sevrani në Shoqërinë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., tek blerësit, dy ortakët e tjerë* ***Shoqëria*** *"Albeton 5"Sh.p.k,* dhe Shoqëria "MC Investment" Group Shpk. kundrejt vlerës totale prej 20.000 Euro, përkatësisht me nga 10.000 Euro secili.

*b. Pas blerjes së kuotave të kapitalit, ortakë të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., do të jenë blerësit* ***Shoqëria*** *"Albeton 5" Shpk, e cila do të zotërojë 62.5% (Gjashtëdhjetë e dy pikë pesë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë dhe shoqëria* "MC Investment" Group Shpk *që do të zotërojë 37.5% (Tridhjetë e shtatë pikë pesë përqind) të pjesëve të kapitalit.*

*c. Të miratojë kërkesën për dorëheqje të administratores së Shoqërisë Zj.Iva Veshi, duke e konsideruar detyrën e Znj.Iva Veshi si administratore, të përfunduar.*

d. *Të emërojë, duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij vendimi, si Administrator Ligjor të vetëm të Shoqërisë* ***Z.Eraldi Bego,*** *duke i dhënë atij të gjitha kompetencat e mundshme të parashikuara në Statut, për një periudhë kohe prej 1(një) vit, me të drejtë rizgjedhje.*

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës, në përfundim, me vullnet të lirë dhe të plotë,

***VENDOSI:***

Të miratojë,

1. Blerjen e 25% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K të zotëruara nga Z.Artan Sevrani, tek bleresi Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k dhe Shoqëria "MC Investment" Group Shpk. kundrejt vlerës totale prej 20.000 Euro, përkatësisht me nga 10.000 Euro secili.
2. Autorizimin e z. Adrian Dulaku, të nënshkruajë aktet përkatëse, si Kontratë Shitje të Kuotave dhe çdo akt tjetër që ka si rend dite:
   - *Kalimin e 25% (njëzet e pesë përqind) të kuotave të kapitalit të zotëruara nga Z.Artan Sevrani në Shoqërinë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., tek blerësit, dy ortakët e tjerë* ***Shoqëria*** *"Albeton 5"Sh.p.k,* dhe Shoqëria "MC Investment" Group Shpk. kundrejt vlerës totale prej 20.000 Euro, përkatësisht me nga 10.000 Euro secili.
   - *Pas blerjes së kuotave të kapitalit, ortakë të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., do të jenë blerësit* ***Shoqëria*** *"Albeton 5" Shpk, e cila do të zotërojë 62.5% (Gjashtëdhjetë e dy pikë pesë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë dhe shoqëria* "MC Investment" Group Shpk *që do të zotërojë 37.5% (Tridhjetë e shtatë pikë pesë përqind) të pjesëve të kapitalit.*
   - *Të miratojë kërkesën për dorëheqje të administratores së Shoqërisë Zj.Iva Veshi, duke e konsideruar detyrën e Znj.Iva Veshi si administratore, të përfunduar.*
   - *Të emërojë, duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij vendimi, si Administrator Ligjor të vetëm të Shoqërisë* ***Z.Eraldi Bego,*** *duke i dhënë atij të gjitha kompetencat e mundshme të parashikuara në Statut, për një periudhë kohe prej 1(një) vit, me të drejtë rizgjedhje.*

Sa më sipër, ky vendim i Ortakut të Vetëm dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë organeve përkatëse.

**SHOQËRIA "ALBETON 5" SHPK**

ALBETON 5 sh.p.k TIRANE

**ORTAKU I VETËM**

**Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" Shpk**

CONCORD Investment sh.p.k

**Përfaqësuar nga**

**Artan Dulaku** | **Adrian Dulaku** | **Genci Dulaku**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER MARIANA DAKA**

V2020053860067979542

**DATE 23/09/2020**
**NR REP 1490**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 23.09.2020, para meje Notere MARIANA DAKA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqiten personalisht :

**NËNSHKRUES/IT**:
**Z.Adrian Dulaku,** atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 05 Shkurt 1960, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 035240347 dhe numër personal G00205223S;

**Z. Artan Dulaku,** atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 30 Maj 1965, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Kompleksi i Vilave, Sauk, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 035434059 dhe me numër personal G50530166T;

**Z.Genci Dulaku,** atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 19 Dhjetor 1967, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : bulevardi "Bajram Curri", godina ETC, kati i 17, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër 036045039 dhe me numër personal G71219083M, lëshuar nga MB;

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, **"Vendim Asambleje "ALBETON 5" Sh.p.k."**, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimitnë përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128të ligjit nr. 110/2018*"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

MARIANA DAKA